



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2019-05

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatëse An Pauër-Ford, Kryetare
Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Roland Dekers

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 shkurt 2019

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Referim dhe kërkesë për masa të përkohshme nga z. Mahir Hasani lidhur me urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit
në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018

Parashtruesi
Mahir Hasani

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

An Pauër-Ford, kryetare
Vidar Stensland, gjykatës
Roland Dekers, gjykatës

Pas kuvendimeve të zhvilluara në largësi me anë të mjeteve të komunikimit elektronik dhe kokë më kokë, shpall Vendimin e mëposhtëm

I. PROCEDURA

1. Më 15 janar 2019, z. Mahir Hasani ('Parashtruesi') i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('Dhoma') një referim që mban datën 11 janar 2019 ('Referimi'),¹ në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta'). Parashtruesi përfaqësohej nga Dr. Artan Qerkini.

2. Në Referim, Parashtruesi bën ankesë se Urdhri i Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS') që e urdhëron atë të paraqesë dokumente dhe informacione ('Urdhri'), cenon të drejtat e tij për të heshtur dhe për mosinkriminimin e vetvetes, si edhe prezumimin e pafajësisë. Parashtruesi mbështetet në nenet 30(6) dhe 31(5) të Kushtetutës dhe në nenin 6(2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ('Konventa').

3. Gjithashtu, Parashtruesi paraqiti kërkesë në bazë të rregullës 21(1) dhe (2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('Rregullorja

¹ KSC-CC-2019-05, F00001, Peticion i z. Mahir Hasani për konstatim të cenimit të të drejtave themelore të tij nga Zyra e Prokurorit të Specializuar përmes lëshimit të Urdhrit VIY689 të datës 20 dhjetor 2018 për të paraqitur dokumente dhe të dhëna dhe kërkesë për masë të përkohshme, Publik (i redaktuar me shtojca konfidenciale, 11 janar 2019).

e Punës'), për një masë të përkohshme për pezullimin e Urdhrit, deri në marrjen e vendimit nga Dhoma për pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit.

4. Më 15 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), caktoi panelin e lartpërmendur për të marrë vendim në lidhje me Referimin.²

5. Më 18 janar 2019, Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese bëri kërkesë në bazë të nenit 3(8)(c) të Ligjit, për ndryshimin e vendit të zhvillimit të kësaj procedure në shtetin pritës, përkatësisht në Holandë.³ Në të njëjtën ditë, në bazë të nenit 20 të Ligjit, paneli vendosi që gjuhët e punës për këtë procedurë të jenë shqipja dhe anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara - shqipe, serbishte, dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative.⁴

6. Më 18 janar 2019, Dhoma e njoftoi Prokurorin e Specializuar lidhur me parashtrimin e përgjigjes.⁵ Dhoma e lejoi Prokurorin e Specializuar që deri më 25 janar 2019 të parashtronte përgjigjen ndaj kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme, në rast se dëshironte.

7. Më 22 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara lëshoi vendimin për zhvillimin e procedurave në fjalë në shtetin pritës.⁶

² KSC-CC-2019-05, F00002, Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, publik, 15 janar 2019.

³ KSC-CC-2019-05, F00004, Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës, publike, 18 janar 2019.

⁴ KSC-CC-2019-05, F00005, Vendim mbi gjuhët e punës, publik, 18 janar 2019.

⁵ KSC-CC-2019-05, F00003, Njoftim në lidhje me parashtrimin e përgjigjes, publik, 18 janar 2019.

⁶ KSC-CC-2019-06, F00002, Vendim për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

8. Më 25 janar 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi përgjigjen ndaj kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme.⁷
9. Më 7 shkurt 2019, Dhoma miratoi kërkesën e Parashtruesit për masë të përkohshme. Dhoma e pezulloi Urdhrin e ZPS-së duke qenë se *'e detyronte* Parashtruesin të paraqiste dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuar në Urdhër [...].⁸
10. Më 13 shkurt 2019, Dhoma e njoftoi Administratoren se vendimin do ta shpallte më 20 shkurt 2019.
11. Më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një Njoftim për Tërheqje të Urdhrit dhe Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit.⁹

II. FAKTET

12. Më 20 dhjetor 2018, ZPS-ja i dorëzoi Parashtruesit dy dokumente, përkatësisht një fletëthirrje për t'u paraqitur për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019 ('Fletëthirrja') dhe Urdhrin për t'i dorëzuar ZPS-së dokumente dhe informacione të caktuara në të njëjtën ditë.
13. Në Urdhër, ZPS-ja shprehej se Parashtruesi ishte 'i detyruar të paraqesë' të gjitha dokumentet dhe informacionet e specifikuar në Urdhër dhe paralajmërohej se mosparaqitja e dokumenteve 'do të konsiderohet mosbindje'¹⁰ dhe si rezultat i kësaj,

⁷ KSC-CC-2019-05, F00008, Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së z. Mahir Hasani për masë të përkohshme, publike, 25 janar 2019.

⁸ KSC-CC-2019-05, F00010, Urdhër në lidhje me kërkesën e Mahir Hasanit për masë të përkohshme, publik, 7 shkurt 2019.

⁹ KSC-CC-2019-05, F00011, Njoftim për Tërheqje të Urdhrit dhe Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit të z. Mahir Hasani, publik, 15 shkurt 2019.

¹⁰ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 3, konfidenciale.

ZPS-ja mund 'të kërkojë nga Dhomat e Specializuara që të merren masa që detyrojnë bindjen ndaj këtij Urdhri'.¹¹

14. Në Urdhër thuhej gjithashtu se kishte 'arsye për të besuar se [Parashtruesi] [ishte] përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës [...]'.¹²

15. Në Fletëthirrje thuhej se Parashtruesi ishte 'i detyruar të paraqitej'¹³ për t'u marrë në pyetje. Më tej, në Fletëthirrje thuhej edhe se në rast mosparaqitjeje të Parashtruesit, ai mund 'të detyrohej të paraqitej, të gjobitej dhe të burgosej'.¹⁴

III. SHKELJET E PRETENDUARA

16. Parashtruesi paraqiti ankesë se Urdhri i ZPS-së që e urdhëronte atë si i dyshuar të paraqiste dokumente dhe informacione të caktuara, cenonte të drejtat e tij për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten sipas nenit 30(6) të Kushtetutës. Ai gjithashtu pretendonte se Urdhri cenonte të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm sipas nenit 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës. Parashtruesi nuk ka bërë ankesë për Fletëthirrjen.

IV. JURIDIKSIONI

17. Dhoma është bindur se ka juridiksion për të shqyrtuar Referimin. Dhoma vëren se neni 162(3) i Kushtetutës përcakton që '[një] Dhomë e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese [...] do të vendosë [...] mbi referimet kushtetuese sipas nenit 113 të

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 2, konfidenciale

¹⁴ Po aty.

Kushtetutës në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar [...]’ (theksimi i shtuar). Gjithashtu, nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit parashikojnë juridiksionin e Dhomës në lidhje me referimet kushtetuese që kanë të bëjnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18. Parashtruesi e ka paraqitur këtë Referim në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës. Në Referim, Parashtruesi paraqet ankesë në lidhje me Urdhrin e ZPS-së. Pra, Referimi ka të bëjë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, siç e kërkon neni 162(3) i Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim mbi Referimin.

V. VLERËSIMI

A. PARASHTRIMET

1. Parashtruesi

19. Duke iu referuar aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut¹⁵ në *John Murray v. the United Kingdom*, Parashtruesi argumenton se, edhe pse nuk përmendet konkretisht në nenin 6 të Konventës, e drejta për t’u mbrojtur në heshtje dhe privilegji i mosinkriminimit të vetvetes janë në gjenezën e parimit të procedurës së drejtë sipas nenit 6. Këto garanci i ofrojnë personit të akuzuar mbrojtje kundër detyrimit të padrejtë nga autoritetet dhe kontribuojnë në shmangien e mohimit të drejtësisë.¹⁶ Sikurse u shpreh Gjykata e Strasburgut në *Heaney and McGuinness v. Ireland*, e drejta e mosinkriminimit të vetvetes presupozon se prokuroria në një çështje penale duhet të përpiqet ta provojë pretendimin kundër të dyshuarit, pa u bazuar në

¹⁵ Në lidhje me këtë, në këtë Vendim të gjitha citimet nga jurisprudenca i referohen jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (‘GJEDNJ’ ose ‘Gjykata e Strasburgut’), përveç nëse specifikohet ndryshe.

¹⁶ *John Murray v. the United Kingdom*, 8 shkurt 1996, Raporte të Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996-I, para. 45.

dëshmi të siguruara përmes metodave të shtrëngimit ose presionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit.¹⁷ Nga *Heaney and McGuinness v. Ireland* rrjedh se kërcënimi dhe imponimi i masave ndëshkimore për mosdhënie informacioni autoriteteve hetimore, mund të përbëjë detyrim të padrejtë.¹⁸ Për më tepër, e drejta për mosinkriminim të vetvetes është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë, parashikuar në nenin 6(2) të Konventës.¹⁹ Parashtruesi pretendon se duke tentuar ta zhvendoste barrën e provës, Urdhri cenonte si privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes, po ashtu edhe prezumimin e pafajësisë.

20. Në lidhje me rrethanat e tij konkrete, Parashtruesi argumenton se ZPS-ja u përpoq ta detyronte atë, një të dyshuar të konfirmuar, të paraqiste dokumente, të dhëna, shënime dhe informacione. Në veçanti, Urdhri shprehej se mosparaqitja e dokumenteve të specifikuara do të konsiderohej 'mosbindje' dhe ndaj tij mund të merreshin masa që siguronin bindjen ndaj Urdhrit. Përveç kësaj, në Fletëthirrje përmendeshin gjobitja dhe burgimi. Gjithashtu, ndonëse e informonte Parashtruesin se ishte i dyshuar, ZPS-ja nuk e kishte informuar atë për arsyet e dyshimit kundër tij. Për rrjedhojë, Parashtruesi pretendon se mund të gjendej para një situatë në të cilën çdo informacion ose dokument që do t'i paraqitej ZPS-së mund të dëmtonte më vonë mbrojtjen e tij si edhe mund t'i jepte Prokurorit të Specializuar një avantazh të papranueshëm nëse Parashtruesi do të dilte para gjyqit.

21. Me anë të këtyre kushteve kaq detyruese të Urdhrit, ZPS-ja tentoi ta detyronte Parashtruesin të cilin ZPS-ja e konsideronte të dyshuar, që të paraqiste prova dhe si rrjedhojë potencialisht të inkriminonte vetveten. Kjo kishte të bënte me një zhvendosje të barrës së provës. Për këtë arsye, Urdhri cenonte të drejtat e Parashtruesit sipas

¹⁷ *Heaney and McGuinness v. Ireland*, nr. 34720/97, ECHR 2000-XII, para. 40. Parashtruesi i referohet gjithashtu edhe *Saunders v. the United Kingdom*, 17 dhjetor 1996, Raporte Aktgjykimesh dhe Vendimesh 1996-V, para. 68; *Bykov v. Russia* [GC], nr. 4378/02, 10 mars 2009, para. 92.

¹⁸ *Heaney and McGuinness v. Ireland*, cituar më lart.

¹⁹ Po aty., para. 40. Parashtruesi i referohet gjithashtu edhe *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 68.

neneve 30(6) dhe 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës. Parashtruesi nuk kishte mjete juridike në dispozicion sipas Kushtetutës, Ligjit ose Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës për të sfiduar Urdhrin dhe për të trajtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit. Për këto arsye, Referimi ishte i pranueshëm.

2. Prokurori i Specializuar

22. Në përgjigjen e tij ndaj kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme, Prokurori i Specializuar, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,²⁰ argumenton se parimi i subsidiaritetit dhe interesat e administrimit të duhur të drejtësisë favorizojnë fuqimisht që procesi i rregullt gjyqësor të lejohet të kalojë nëpër hapat përkatës. Parashtruesi kishte në dispozicion mjete juridike për t'i trajtuar shkeljet e pretenduara si, për shembull, paraqitja e çështjeve për të cilat bëhej ankesë para një gjykatësi të procedurës paraprake ose një gjykatësi të vetëm të caktuar në bazë të nenit 33 të Ligjit. Duke qenë se Parashtruesi nuk i kishte shterur të gjitha këto mjete juridike, Referimi ishte i papranueshëm në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit.

23. Prokurori i Specializuar gjithashtu argumentonte se pretendimi i Parashtruesit, se ZPS-ja mund të ngrinte aktakuzë kundër tij dhe të përdorte dokumentet dhe informacionet e përfutuara në bazë të Urdhrit, ishte tejet hamendësues. Ai argumentonte se, edhe nëse do të ndodhte kështu, do të duhej të kalohej në shumë nivele të mbikëqyrjes gjyqësore dhe se Parashtruesi mund të bënte kërkesë për

²⁰ Prokurori i Specializuar përmend, për shembull, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj C. nr. 6/2008 të 5 nëntorit 2012, C nr. 364/2009 të 19 dhjetorit 2012 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj C. nr. 534/10 të 15 marsit 2013, KI 58/13, Aktvendim për papranueshmëri, 16 tetor 2013 (25 nëntor 2013), para. 28-32; Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka nr. 562/12 të 8 tetorit 2012, KI 17/13, Vendim për kërkesën për masë të përkohshme, 14 mars 2013, para. 27-28.*

përfundimit të materialit të kontestuar nga provat. Referimi i Parashtruesit ishte i parakohshëm.

B. VLERËSIMI I DHOMËS

1. Reflektime paraprake mbi Ligjin

24. Dhoma rikujton detyrën e vet për mbikëqyrjen e punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Në përputhje me nenin 49(1) të Ligjit, Dhoma është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës për sa i takon juridiksionit lëndor dhe punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

25. Për sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, neni 22(2) i saj parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës. Gjithashtu, sipas nenit 53, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë 'interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]'. Gjykata Kushtetuese e Kosovës vazhdimisht e ka njohur zbatimin e nenit 53 në vlerësimet e referimeve kushtetuese.²¹ Gjithashtu, ajo është shprehur se 'Gjykata Kushtetuese është e obliguar që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]'.²²

²¹ Shih, për shembull, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017*, KI 34/18, Aktvendim për papranueshmëri, 23 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 41. Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017*, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 37; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN. II nr. 1/17 të 30 janarit 2017 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 300/16 të 12 dhjetorit 2016*, KI 62/17, Aktgjykim, 29 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 43.

²² Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës PML. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015*, KI 43/16, Aktvendim për papranueshmëri, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50 (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu edhe Gjykata Kushtetuese e

26. Mbi këtë bazë dhe duke pasur parasysh nenet 22(2) and 53 të Kushtetutës, kjo Dhomë ka mbajtur parasysh në veçanti parasysh jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut në shqyrtimin e ankesës së Parashtruesit se Urdhri që e urdhëronte atë të paraqiste dokumente dhe informacione, cenonte të drejtat e tij kushtetuese për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten. Gjithashtu, Dhoma ka mbajtur parasysh jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut edhe në marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për ta hedhur poshtë Referimin në fjalë.

2. Shkeljet e pretenduara

27. Në thelb, Referimi i Parashtruesit ka të bëjë me të drejtën për të heshtur dhe të drejtën e mosinkriminimit të vetvetes, të garantuara në nenin 30(6) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Sikurse është shprehur GJEDNJ-ja në *Saunders v. the United Kingdom*, ndonëse nuk përmenden specifikisht në nenin 6 të Konventës, e drejta për të heshtur dhe e drejta e mosinkriminimit të vetvetes janë standarde të pranuar ndërkombëtarisht në procedura penale dhe janë në gjenezën e parimit të procedurës së drejtë sipas nenit 6 të Konventës.²³ Këto standarde të pranuar ndërkombëtarisht pasqyrohen, për shembull, në Direktivën 2016/343 të Bashkimit Evropian për fuqizimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedura penale. Si krahasim, Dhoma vëren se në bazë të nenit 2, Direktiva është e zbatueshme, ndër të tjera, për të dyshuarit në procedura penale. Neni 7 sanksionon të drejtën për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes.

28. Referimi i Parashtruesit ngre çështjen nëse garancitë e parashikuara në nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës janë të zbatueshme edhe në fazën hetimore

Kosovës, *Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, KI 41/12, Aktgjykim, 25 janar 2013 (26 shkurt 2013), para. 58.

²³ *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 68.

dhe në veçanti në rrethanat në të cilat autoritetet e urdhërojnë një të dyshuar të konfirmuar që të paraqesë dokumente dhe informacione gjatë marrjes në pyetje.

- (a) Zbatueshmëria e garancive kushtetuese kur 'dikush është objekt i një akuze penale'

29. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, mbrojtjet e ofruara nga neni 6(1) dhe (3) i Konventës janë të zbatueshme për një person që është *objekt i një 'akuze penale'*.²⁴ Neni 30 i Kushtetutës gjithashtu parashikon të drejtat minimale të një personi 'të akuzuar për veprë penale'.²⁵ Në jurisprudencën e saj, Gjykata e Strasburgut përdor qasjen materiale përkundër asaj formale për t'i dhënë përgjigje pyetjes se kur një person mund të konsiderohet se është objekt i një akuze penale.

30. Në veçanti, Gjykata e Strasburgut ka konfirmuar se 'akuza penale' ekziston që prej momentit kur personi njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për pretendimin se ka kryer një veprë penale, ose që prej momentit kur situata e tij ose e saj ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga veprimet e ndërmarra prej autoriteteve si rrjedhojë e dyshimit kundër tij ose saj.²⁶

31. Në lidhje me ankesat e bëra prej Parashtruesit, domethënie të veçantë ka vendimi në *Aleksandr Zaichenko v. Russia*,²⁷ i konfirmuar më vonë në *Ibrahim and Others v. the United Kingdom*.²⁸ Në rastin e parë, një i dyshuar që ishte marrë në pyetje lidhur me përfshirjen e tij në veprime që përbënin veprë penale u konsiderua nga GJEDNJ-ja se ishte objekt i një 'akuze' në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Gjykata shpjegoi se, me të ekzistuar dyshimi për vjedhje kundër parashtruesit, ishte detyra e policisë që ta

²⁴ *Simeonovi v. Bulgaria* [GC], nr. 21980/04, 12 maj 2017, para. 110 (theksimi i shtuar). Shih edhe *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, 13 shtator 2016, para. 249.

²⁵ Neni 30 i Kushtetutës, në pjesën përkatëse, përcakton si vijon: 'Çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale në vijim: [...]'. (theksimi i shtuar).

²⁶ Shih, për shembull, *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 249, 253.

²⁷ *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, nr. 39660/02, 18 shkurt 2010.

²⁸ *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 270.

informonte atë lidhur me të drejtën për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes.²⁹

32. Në rastin tonë, Urdhri i lëshuar nga ZPS-ja i konfirmonte Parashtruesit se kishte arsye për të besuar që ai ishte përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.³⁰ Duke qenë se Urdhri konfirmonte qartë ekzistencën e një dyshimi kundër Parashtruesit, Dhoma pranon që në rastin e Parashtruesit vepron dhe janë të zbatueshëm neni 30 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës, në veçanti e drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkriminimit të vetvetes.

(b) E drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkriminimit të vetvetes

33. Dhoma rikujton se qëllimi i së drejtës për të heshtur dhe i privilegjit të mosinkriminimit të vetvetes është që të mbrojë personin e akuzuar nga detyrimi i palejueshëm prej autoriteteve dhe rrjedhimisht të shmangë mohimin e drejtësisë dhe të mbrojë synimet e nenit 6 të Konventës.³¹ Është ekzistenca e elementit të detyrimit ajo që ngre çështjen nëse është respektuar privilegji i mosinkriminimit të vetvetes.³² Shkelja e nenit 6 ndodh kur niveli i detyrimit në fjalë shuan vetë thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetvetes.³³

34. Në lidhje me ankesën e Parashtruesit mbi detyrimin në këtë çështje, ai argumentoi se në Fletëthirrjen që i kërkonte të paraqitej për marrje në pyetje,

²⁹ *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, cituar më lart, para. 41-43, 52. Shih edhe *Yankov and Others v. Bulgaria*, nr. 4570/05, 23 shtator 2010, para. 23; *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 296.

³⁰ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 3, konfidenciale.

³¹ *Bykov v. Russia* [GC], cituar më lart, para. 92.

³² *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 267.

³³ Po aty., para. 269. Shih gjithashtu *Heaney and McGuinness v. Ireland*, cituar më lart, para. 54-55; *O'Halloran and Francis v. the United Kingdom* [GC], nr. 15809/02 dhe 25624/02, ECHR 2007-III, para. 55; *Bykov v. Russia* [GC], cituar më lart, para. 92-93. Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017*, cituar më lart, para. 59-61.

përmendej dënim me gjobë dhe burgim (shih paragrafin 20 më lart). Sidoqoftë, Dhoma vëren se paralajmërimi kishte të bënte vetëm me detyrimin e 'paraqitjes për marrje në pyetje'.³⁴ Rrjedhimisht dhe duke mbajtur parasysh se Parashtruesi nuk dorëzoi ankesë kundër Fletëthirrjes për t'u paraqitur për marrje në pyetje (shih paragrafin 16 më lart), Dhoma nuk do ta marrë parasysh atë paralajmërim në marrjen e vendimit lidhur me Referimin.

35. Gjithashtu, Parashtruesi solli në vëmendjen e Dhomës elementin e detyrimit që përmbante Urdhri për paraqitjen e dokumenteve dhe informacionit. Ky element përbëhej nga një paralajmërim se nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet, kjo mosparaqitje 'do të konsiderohet mosbindje' dhe si pasojë Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të kërkonte masa detyruese për të siguruar bindjen ndaj Urdhrit.³⁵

36. Dhoma është bindur se sipas kushteve të formuluar në Urdhër, ekzistonte një element i qartë detyrimi. Faktikisht, ky element përbëhej nga një *paralajmërim* se nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet e specifikuar,³⁶ kjo mosparaqitje do të konsiderohej 'mosbindje'. Kërcënimi se do të nisej procedim ligjor për të detyruar zbatimin nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet e forconte edhe më tej elementin e detyrimit. Në kuadër të procedurës në fjalë, Dhoma e gjykon të përshtatshme të rikujtojë dy aspekte përkatëse në juridiksionin e Gjykatës së Strasburgut lidhur me pasojat e një detyrimi të tillë. Aspekti i parë ka të bëjë me përdorimin e mëvonshëm në gjykim të informacionit të përftuar nën kërcënimin e masave ndëshkuese, dhe i dyti lidhet me rrethanat kur të dyshuarit ndëshkohen në qoftë se refuzojnë të japin informacionin e kërkuar nën kërcënim.³⁷

³⁴ KSC-CC-2019-05, F00001, A02, Shtojca 2, konfidenciale.

³⁵ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 3, konfidenciale.

³⁶ Gjykata e Strasburgut nuk e ka kufizuar zbatimin e nenit 6 të Konventës vetëm në situata kur autoritetet i kërkojnë një të dyshuari t'u përgjigjet pyetjeve. Ky nen vlen gjithashtu për situata kur një personi i kërkohet të dorëzojë dokumente. Shih *J.B. v. Switzerland*, nr. 31827/96, ECHR 2001-III, para. 65-66. Shih gjithashtu *Funke v. France*, 25 Shkurt 1993, Series A nr. 256-A, para. 41, 44.

³⁷ Shih gjithashtu *O'Halloran and Francis v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 43.

(i) Përdorimi i mëvonshëm i informacionit në gjykim

37. Aspekti i parë i jurisprudencës mund të shihet në çështje si *Saunders v. the United Kingdom*, ku një i dyshuar detyrohet të japë dëshmi si rezultat i kërcënimit me masa ndëshkimore në rast mosdhënie të informacionit. I dyshuari duke qenë nën kërcënimin e masave ndëshkimore ligjore, e jep dëshminë dhe dëshmia e marrë në këtë mënyrë përdoret më vonë në gjykimin e atij personi.³⁸

38. Në rastin tonë, Parashtruesi argumentoi se në rast se do të ketë gjykim kundër tij, materialet e dhëna në bazë të Urdhrit, mund ta dëmtonin mbrojtjen e tij dhe t'i jepnin një avantazh të padrejtë Zyrës së Prokurorit të Specializuar (shih fundin e paragrafit 20 më lart). Sidoqoftë, ndryshe nga *Saunders v. the United Kingdom*, në rastin e Parashtruesit as nuk është zhvilluar gjykim, as nuk ka pasur vendim fajësie. Dhoma nuk mund të hamendësojë nëse Parashtruesi do të ishte përballur me gjykim, nëse do të ishin përdorur dokumentet e specifikuar në Urdhër, nëse Parashtruesi do të ishte shpallur fajtor dhe nëse, si pasojë, do të ishte komprometuar drejtësia e gjykimit në tërësi, nëse do të ishte zhvilluar një i tillë.³⁹

39. Sikurse është konstatuar nga Gjykata e Strasburgut, neni 6 i Konventës mund të jetë i zbatueshëm në procedurën paraprake 'në qoftë se dhe për aq sa drejtësia e gjykimit ka të ngjarë të cenohet rëndë nga një mosrespektim fillestar [paraprak] i [...] dispozitave [të nenit 6]'.⁴⁰ Gjithashtu, 'ankesat sipas nenit 6 në lidhje me fazën hetimore priren të qartësohen gjatë vetë gjykimit kur prokuroria bën kërkesë për pranimin e provave të siguruara gjatë procedurës paraprake dhe mbrojtja e kundërshton kërkesën'.⁴¹

³⁸ Shih *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 57, 67 në fund, 69-76.

³⁹ Shih *Nikolova v. Bulgaria* (dec.), nr. 31195/96, 27 shkurt 1997.

⁴⁰ *Salduz v. Turkey* [GC], nr. 36391/02, ECHR 2008, para. 50 (theksi i shtuar). Shih gjithashtu *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 253. Shih gjithashtu *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017*, cituar më lart, para. 61 e në vijim.

⁴¹ *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 254, me referenca të mëtejshme.

40. Duke marrë parasysh se Referimi kishte të bënte me fazën hetimore të procedurave, në këto rrethana, Dhoma nuk mund të vlerësojë nëse Urdhri i lëshuar do të kishte komprometuar drejtësinë e gjykimit, nëse do të kishte një të tillë kundër Parashtruesit. Nëse Urdhri nuk do të ishte tërhequr, ky aspekt i ankesës së Parashtruesit, pra që detyrimi për të paraqitur dokumentet e specifikuar do të kishte ndikuar në drejtësinë e gjykimit, ishte i parakohshëm.⁴²

(ii) Masat ndëshkimore për refuzimin e dhënies së informacionit

41. Aspekti i dytë përkatës në jurisprudencën e Strasburgut lidhet me masat ndëshkimore që merren kundër një të dyshuari që refuzon të paraqesë informacion konkret. Ky problem del në rastet kur të dyshuarit i kërkohet të paraqesë informacion si në *Heaney and McGuinness v. Ireland*,⁴³ ose dokumente si në *J.B. v. Switzerland*,⁴⁴ nën kërcënimin e masës ndëshkimore dhe në vijim ndëshkohet kur refuzon ta bëjë këtë. Në rrethana të tilla, në kuadrin e nenit 6 mund të dalë një problem edhe në qoftë se ndaj individit nuk ngrihet aktakuzë në bazë të procedurës fillestare, ose në qoftë se shpallet i pafajshëm pas gjykimit, nëse do të ketë një të tillë.⁴⁵ Thelbi i këtij aspekti të jurisprudencës ka të bëjë me ndëshkimin e individit për mosdhënien e provave.

42. Sipas argumentimit të Parashtruesit, Urdhri i lëshuar përbënte një detyrim të palejueshëm për t'i dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar prova potenciale, sepse përmbante paralajmërimin se mosparaqitja e dokumenteve nga Parashtruesi do të

⁴² Shih *Nikolova v. Bulgaria* (dec.), cituar më lart. Shih gjithashtu *Guliyev v. Azerbaijan* (dec.), nr. 35584/02, 27 maj 2004; *Fedko v. Ukraine* (dec.), nr. 17277/03, 4 dhjetor 2006; *Hradecký v. Czech Republic* (dec.), nr. 76802/01, 26 shkurt 2002; *Karalevičius v. Lithuania and Russia* (dec.), nr. 53254/99, 17 tetor 2000; *Ziacik v. Slovenia* (dec.), nr. 43377/98, 27 Janar 2000.

⁴³ *Heaney and McGuinness v. Ireland*, cituar më lart, para. 41, 45, 55.

⁴⁴ *J.B. v. Switzerland*, cituar më lart, para.63, 65-71. Shih gjithashtu *Funke v. France*, cituar më lart, para. 41, 44.

⁴⁵ Shih gjithashtu *O'Halloran and Francis v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 35 në fund; *Shannon v. the United Kingdom*, nr. 6563/03, 4 tetor 2005, para. 26, 33-35.

konsiderohej mosbindje dhe si rezultat i kësaj mund të merreshin masa për të siguruar bindjen ndaj Urdhrit (shih paragrafin 20 më lart).

43. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se është e vërtetë se në Urdhër thuhej se mosparaqitja e dokumenteve nga Parashtruesi do të konsiderohej 'mosbindje', dhe si rezultat i kësaj mund të merreshin masa për të siguruar bindjen ndaj Urdhrit.⁴⁶ Në lidhje me kushtet e Urdhrit të lëshuar, Dhoma rikujton se në *Heaney dhe McGuinness v. Ireland*, Gjykata e Strasburgut konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës në rrethanat kur, gjatë kryerjes së një hetimi penal, oficerët e policisë u kishin kërkuar të dyshuarve informacione të caktuara nën kërcënimin e masave ndëshkimore. Të dyshuarit kishin refuzuar ta bënin një gjë të tillë dhe në vijim autoritetet i kishin ndjekur ata penalisht për mosdhënien e informacionit.⁴⁷

44. Dhoma gjykon se paralajmërimi për nxjerrjen e konstatimit të 'mosbindjes' dhe kërcënimi me masa detyruese me të cilat u përball Parashtruesi janë në kuadër të aspektit të lartpërmendur të jurisprudencës. Dhoma gjykon se konstatimi për 'mosbindje' dhe masat detyruese që mund të merreshin në bazë të tij kundrejt refuzimit të Parashtruesit për dhënie dokumentesh, sipas të gjitha gjasave do të kishin çuar në një situatë të palejueshme sipas nenit 30(6) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

VI. VËREJTJE TË TJERA

45. Duke mbajtur parasysh natyrën e palejueshme të Urdhrit të lëshuar prej ZPS-së, Dhoma duke pasur qëllim ruajtjen e të drejtave kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten, më 7 shkurt pezulloi Urdhrin duke qenë

⁴⁶ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 3, Konfidenciale.

⁴⁷ *Heaney and McGuinness v. Ireland*, cituar më lart, para. 10, 41, 45, 47-59.

se *detyronte* Parashtruesin të paraqiste dokumente dhe informacion ⁴⁸ Masa e përkohshme siguroi ruajtjen e statukuosë deri në marrjen e vendimit për Referimin, dhe që kundër Parashtruesit të mos mund të nxirrej konstatim për mosbindje, as të mos mund të merreshin masa detyruese në qoftë se do të kishte zgjedhur të ushtronte të drejtën e tij për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten kur të paraqitej për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019.

46. Pasi ka shqyrtuar situatën e Parashtruesit, Dhoma është bindur se, në rrethanat e tanishme, kundër Parashtruesit nuk ekziston asnjë konstatim për mosbindje dhe as nuk janë marrë masa detyruese për mosparaqitjen e dokumenteve të specifikuara në Urdhër. Në qoftë se Urdhri nuk do të ishte tërhequr (shih paragrafin 11 më lart) dhe në qoftë se do të ishin nisur procedura të tilla, atëherë mund të kishte dalë problemi lidhur me të drejtën për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes, edhe sikur statusi i Parashtruesit të mos ndryshonte nga i dyshuar në të akuzuar.

47. Pasojat e konstatimit të mosbindjes dhe marrjes së masave detyruese prej ZSP-së kundër Parashtruesit për ushtrimin e të drejtave të tij kushtetuese, janë shtjelluar qartësisht këtu duke iu referuar në veçanti konstatimit të Gjykatës së Strasburgut për shkelje të nenit 6 të Konventës në *Heaney and McGuinness v. Ireland* (shih paragrafët 43 dhe 44 më lart).

48. Dhoma rikujton se autoritetet mund të përdorin një sërë masash për të siguruar material me gjasë të rëndësishëm për një hetim pa kryer shkelje të privilegjit të mosinkriminimit të vetvetes. Dhoma rikujton se ky privilegj nuk zbatohet për përdorimin në procedura penale të materialit që mund të sigurohet përmes ushtrimit

⁴⁸ KSC-CC-2019-05, F00010, Urdhër në lidhje me kërkesën e Mahir Hasanit për masë të përkohshme, publik, 7 shkurt 2019.

të kompetencave detyruese, por që ekziston pavarësisht nga vullneti i të dyshuarit, si për shembull kur provat sigurohen nëpërmjet një urdhri për kontroll.⁴⁹

49. Dhoma është e mendimit se e drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkrimimit të vetvetes në bazë të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, ishin objekt i kushteve të Urdhrit të lëshuar. Sikurse është theksuar në vendimin që miraton masën e përkohshme, në pamje të parë Urdhri ishte problematik duke qenë se *e detyronte* Parashtruesin, një i dyshuar i konfirmuar, që të paraqiste dokumente dhe informacion dhe e paralajmëronte atë për konstatim *mosbindjeje* dhe për masa të mundshme detyruese në rast se nuk do t'i paraqiste dokumentet e specifikuar në Urdhër.

50. Në përputhje me nenin 49(1) dhe (3) të Ligjit, detyra e Dhomës është të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat ka paraqitur ankesë parashtruesi kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij si individ të garantuara prej Kushtetutës. Nuk është detyrë e kësaj Dhome të trajtojë gabime të pretenduara të faktit ose të ligjit gjatë procedurës penale përveçse dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë të bëjnë me shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese.⁵⁰ Ankesat e Parashtruesit në Referim ngritën çështje të rëndësishme në lidhje me shkelje të pretenduara të të drejtave të kushtetuese të tij.

⁴⁹ *O'Halloran and Francis v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 47; *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 69. Shih gjithashtu *Jalloh v. Germany* [GC], nr. 54810/00, ECHR 2006-IX, para. 102; *P.G. and J.H. v. the United Kingdom*, nr. 44787/98, ECHR 2001-IX, para. 80.

⁵⁰ Në lidhje me këtë, shih *Bochan v. Ukraine* (nr. 2) [GC], nr. 22251/08, ECHR 2015, para. 61; *Perez v. France* [GC], nr. 47287/99, ECHR 2004-I, para. 82. Shih gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, *Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017, cituar më lart, para. 38; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml Nr. 44/2018 të 10 prillit 2018*, KI 72/18, Aktvendim për papranueshmëri, 22 nëntor 2018 (14 dhjetor 2018), para. 40; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, nr. 24/07/2006, të 30 shtatorit 2009 KI 55/09, Aktgjykim, 13 dhjetor 2010 (6 prill 2011), para. 18, 21.

VII. NGJARJET PAS PARASHTRIMIT TË REFERIMIT

51. Dhoma vëren se më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një Njoftim për Tërheqje të Urdhrit që është objekt i këtij Referimi, si dhe një Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit në fjalë (shih paragrafin 11 më lart).

52. Prokurori i Specializuar argumentonte se duke e tërhequr Urdhrin, rrethanat për të cilat paraqiste ankesë Parashtruesi në Referimin e paraqitur, pushonin së ekzistuari. Ai argumentonte më tej se çdo pasojë e mundshme e ndonjë shkeljeje të pretenduar të të drejtave të Parashtruesit tashmë është ndrequr, së pari përmes masës së përkohshme të urdhëruar nga kjo Dhomë dhe së dyti, si rezultat i tërheqjes së Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar.

53. Në lidhje me argumentin e Prokurorit të Specializuar se shkeljet e pretenduara të të drejtave të Parashtruesit janë ndrequr, Dhoma rikujton se sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, në parim, një vendim ose masë në favor të një parashtruesi nuk është e mjaftueshme për t'i hequr atij statusin e viktimës, përveç nëse autoritetet shtetërore e kanë pranuar, qoftë shprehimisht apo në thelb, dhe kanë ndërmarrë në vijim masa ndreqëse në lidhje me shkeljen e Konventës.⁵¹

54. Dhoma vëren se tërheqja e Urdhrit prej Prokurorit të Specializuar, as pranon shkelje të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit, as ofron masë ndreqëse. Megjithatë, Dhoma është e mendimit se në këtë fazë të hershme të procedurës dhe veçanërisht në rrethanat kur Referimi i Parashtruesit nuk është deklaruar i pranueshëm, nuk është e nevojshme të merret në shqyrtim mjaftueshmëria e pranimi apo e masës ndreqëse. Ky shqyrtim do të ishte i nevojshëm vetëm në rast se do të ishte konstatuar faktikisht shkelje e të drejtave kushtetuese të Parashtruesit.⁵²

⁵¹ Shih *Scordino v. Italy* (nr. 1) [GC], nr. 36813/97, ECHR 2006-V, para. 180; *Gäfgen v. Germany* [GC], nr. 22978/05, ECHR 2010, para. 115; *Nada v. Switzerland* [GC], nr. 10593/08, ECHR 2012, para. 128.

⁵² Shih *Sakhnovskiy v. Russia* [GC], nr. 21272/03, 2 nëntor 2010, para. 66.

55. Gjykata e Strasburgut ka konfirmuar se çështja nëse një parashtrues mund të deklarojë se është viktimë e një shkeljeje të pretenduar, ka rëndësi në të gjitha fazat e procedurës.⁵³ Dhoma është e mendimit se në përcaktimin nëse një çështje duhet të hidhet poshtë, ajo mund të marrë parasysh ngjarjet që ndodhin pas dorëzimit të Referimit.⁵⁴ Për Dhomën, çështja nëse Parashtruesi mund të pretendojë ende se është viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese, në thelb do të thotë se duhet të merren parasysh realitetet e situatës së tij. Rrjedhimisht, nuk duhet marrë parasysh vetëm pozita formale në kohën e paraqitjes së referimit, por të gjitha rrethanat e rastit në fjalë. Kjo do të thotë gjithashtu se duhen marrë parasysh patjetër edhe zhvillimet e ndodhura që prej dorëzimit të Referimit.⁵⁵

56. Në shqyrtimin e të gjitha rrethanave të këtij rasti, Dhoma vëren se në Referim Parashtruesi i ka kërkuar kësaj Dhome ta anulojë Urdhrin e ZPS-së, ose ndryshe 'të urdhërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar të anulojnë të njëjtin Urdhër'. Me dorëzimin e Njoftimit për Tërheqje të Urdhrit, Prokurori i Specializuar në fakt dhe me vullnetin e tij, e ka tërhequr Urdhrin. Kjo masë e ka kthyer faktikisht Parashtruesin në gjendjen që ishte para se të lëshohej Urdhri.

57. Në këto rrethana, Dhoma nxjerr përfundimin se për Parashtruesin nuk ekzistojnë më arsye objektive për të proceduar më tej me Referimin. Dhoma është bindur se me tërheqjen e Urdhrit, rrethanat e kundërshtuara nga Parashtruesi nuk qëndrojnë më. Po kështu, Dhoma është bindur se janë shmangur pasojat e ndonjë shkeljeje të mundshme të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit si pasojë e Urdhrit të lëshuar.

⁵³ Shih *Tănase v. Moldova* [GC], nr. 7/08, ECHR 2010, para. 105.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

58. Dhoma gjykon se respektimi i të drejtave të njeriut sikurse përkufizohet në Kushtetutë, nuk ia bën të nevojshme të vazhdojë shqyrtimin e referimit të Parashtruesit.

59. Duke u bazuar në sa më sipër dhe duke marrë parasysh faktin se janë ruajtur të drejtat kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten, Dhoma është bindur se në rrethanat e tanishme ankesat e tij sipas nenit 30(6) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës janë të papranueshme për arsye të mungesës së statusit si viktimë. Ky përfundim vlen edhe për shkeljen e pretenduar të nenit 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës, duke marrë veçanërisht parasysh se Parashtruesi pretendonte se urdhri kishte cenuar prezumimin e pafajësisë duke u përpjekur t'i kalonte atij barrën e provës (shih paragrafin 19 në fund dhe 21 më lart).⁵⁶

60. Duke marrë parasysh përfundimin e Dhomës se Referimi është i papranueshëm për arsye të mungesës së statusit si viktimë, Dhoma nuk e gjykon të nevojshme të trajtojë në veçanti pretendimin e Parashtruesit se nuk ekzistonin mjete juridike në dispozicion të tij, as argumentin e Prokurorit të Specializuar në lidhje me mosshkrimin e pretenduar të mjeteve juridike.

61. Duke qenë se Urdhri që përbën bazën e ankesës së Parashtruesit është tërhequr, Referimi duhet të deklarohet i papranueshëm në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së Punës.

62. Në bazë të rregullës 21(6) të Rregullores së Punës dhe duke mbajtur parasysh tërheqjen e Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar, masa e përkohshme e urdhëruar më 7 shkurt 2019 pushon së vepruari menjëherë.

⁵⁶ Sa i përket lidhjes midis të drejtës për të heshtur dhe privilegjit të mosinkrimimit të vetvetes në një anë dhe prezumimit të pafajësisë në anën tjetër, shih, për shembull, *Krumpholz v. Austria*, nr. 13201/05, 18 mars 2010, para. 30.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

E deklaron të papranueshëm Referimin në lidhje me Urdhrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 20 dhjetor 2018.

/nënshkrim/
Gjykatëse An Pauër-Ford
Kryetare e Dhomës

Hartuar në anglishte, e mërkurë më 20 shkurt 2019
Në Hagë, Holandë